



Në mbështetje të nenit 64.2, paragrafi (a) dhe (b), neneve 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81 dhe 128.2 dhe të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), dhe nenit 22 dhe 29.2 Ligjit nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, (LZL), Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datën 09.03.2023, miraton këtë:

RREGULLORE NR. 11/2023 PËR KËSHILLAT E VENDVOTIMEVE

Neni 1 Fushëveprimi

Kjo Rregullore përcakton mënyrën e themelimit dhe përbërjen, nominimi nga subjektet politike, kualifikimin dhe kriteret për emërim të Këshillave të Vendvotimit (KVV), emërimin, zëvendësimin, përfundimin e anëtarësisë, të drejtat, detyrat, funksionimi, dokumenti i identifikimit (disktinktivin), orari i punës dhe vendimmarrjen e KVV.

Neni 2 Themelimi dhe përbërja e KVV

1. KVV është trup zgjedhor i themeluar nga KQZ, i cili është përgjegjës për përgatitjen dhe administrimin e procesit zgjedhor në vendvotim (VV).
2. Përbërja e KVV reflekton strukturën e anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (KKZ), si dhe strukturën gjinore sipas LZP.
3. Në raste të caktuara, me propozim të KKZ, KQZ mund të shtojë ose zvogëlojë numrin e anëtarëve të KVV, ose të zëvendësojë anëtarin.
4. KVV përbëhet nga: Kryesuesi i KVV, kontrolluesi i rreshtit, zyrtari i identifikimit, dhënësi i fletëvotimit, mbikëqyrësi i kutisë së votimit.
5. Në rastet kur janë më shumë se pesë anëtarë, anëtari i gjashtë mban shënime statistikore lidhur me pjesëmarrjen e votuesve dhe anëtari i shtatë ndihmon dhënësin e fletëvotimeve.

Neni 3

Nominimet e KVV

1. Bazuar në nenin 2, paragrafi 2 të kësaj Rregulloreje, të drejtë nominimi për anëtarë të KVV kanë:
 - 1.1. Subjektet politike të përfaqësuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe të cilat marrin pjesë në zgjedhjet aktuale;
 - 1.2. subjektet politike të përfaqësuara në kuvendin komunal dhe të cilat marrin pjesë në zgjedhjet aktuale në komunën përkatëse.
2. Nëse nuk plotësohen kriteret nga paragrafi 1 i këtij neni, KQZ kërkon nga subjektet politike të reja (të certifikuara për zgjedhje) dhe organizatat jo qeveritare (OJQ), t'i dorëzojnë nominimet plotësuese për KVV.
3. Në rast kur kemi numër të vogël të subjekteve politike të certifikuara, KQZ me vendim mund të miratojë formulë tjetër nga paragrafi 1 dhe paragrafi 2 i këtij neni, duke u bazuar në rezultatet e zgjedhjeve paraprake.
4. Nëse nominimet për KVV, sipas paragrafi 1, 2 dhe 3 të këtij neni, nuk përmbushen, nominimet plotësuese bëhen nga KKZ, me miratimin paraprak të KQZ.
5. Në kohën e përcaktuar nga KQZ, ftohen të gjitha subjektet politike, sipas paragrafit 1, 2 dhe 3 të këtij neni, të dorëzojnë në KKZ nominimet për anëtarë të KVV në komunat përkatëse.
6. Subjektet politike, nominimet e tyre në KKZ i dërgojnë në mënyrë elektronike dhe fizike, jo më vonë se 5 ditë nga dita e pranimit të ftesës së bërë nga KQZ.
7. Lista e nominimeve duhet të përmbajë:
 - 7.1. Kodin e komunës;
 - 7.2. emrin dhe numrin e QV;
 - 7.3. numrin e VV;
 - 7.4. emrin dhe akronimin e subjektit politik ose OJQ;
 - 7.5. emrin e personit kontaktues me KKZ;
 - 7.6. emrin e të nominuarit;
 - 7.7. mbiemrin,
 - 7.8. numrin personal;
 - 7.9. datën e lindjes;
 - 7.10. numrin e telefonit;
 - 7.11. numrin e llogarisë bankare çdo të nominuari;
 - 7.12. përvojën në zgjedhje;

- 7.13. arsimimin;
 - 7.14. pozitën;
 - 7.15. nënshkrimin e personit kontaktues të subjektit politik apo OJQ;
 - 7.16. nënshkrimin e pranuesit të listës nga përfaqësuesi apo kryesuesi i KKZ;
 - 7.17. data dhe vendi i dorëzimit të listës së nominimeve.
8. Subjektet me të drejtë nominimi, do të bëjnë nominime të veçanta për KVV për votimin e personave me nevoja të veçanta. Për numrin e nevojshëm do të vendosë KKZ, varësisht prej numrit të ekipeve mobile.

Neni 4

Kualifikimi dhe kriteret për emërim në KVV

1. Për t'u nominuar dhe emëruar anëtari KVV, personi duhet:
 - 1.1. Të jetë votues i regjistruar në të njëjtën komunë ku është QV/VV;
 - 1.2. të ketë të paktën arsimim të mesëm.
2. Asnjë person nuk mund të nominohet e as emërohet në KVV në kundërshtim me nenin 75.3 të LZP, nëse me vendim të KQZ apo Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia është vërtetuar që ka cenuar procesin zgjedhor, apo ndaj të cilit është duke u zhvilluar procedurë penale nga kapitulli XVIII i Kodit Penal të Kosovës.

Neni 5

Emërimi i anëtarëve, kryesuesve të KVV

1. KKZ pas pranimit të listës së të nominuarve për KVV, ua cakton QV/VV dhe pozitën, duke zbatuar rregullat si në vijim:
 - 1.1. Një subjekt politik nuk mund të ketë më shumë se një përfaqësues/anëtar në KVV;
 - 1.2. nuk mund të emërohet më shumë se një person prej familjes së ngushtë në të njëjtin KVV, pavarësisht se mund të jenë nga subjekte politike të ndryshme (familjar të ngushtë përfshinë: bashkëshortët, fëmijët, prindërit dhe motrat apo vëllezërit);
 - 1.3. të nominuarit emërohen në të njëjtën QV/VV ku janë regjistruar për të votuar, apo të paktën në QV më të afërt ku ka për të votuar.
2. KKZ pranon listën e nominimeve për KVV nga subjektet politike dhe e dërgon në KQZ për emërim, jo më vonë se 5 ditë pune nga dita e pranimit të nominimeve, ndërsa KQZ bën emërimin e KVV, duke përfshirë dhe stafin rezervë për KVV, jo më vonë se 4 ditë nga dita e pranimit të listës së nominimeve.

3. Kryesuesit e KVV zgjedhen në mënyrë të barabartë nga katër subjektet e para që kanë fituar numrin më të madh të votave për Parlamentin e Kosovës gjatë zgjedhjeve të fundit në atë komunë, dhe janë certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet aktuale.
4. Caktimi i kryesuesve të KVV, sipas paragrafit 3 të këtij neni, bëhet përmes formulës së rotacionit të cilën e zbaton KKZ, sipas renditjes së votave që kanë fituar në zgjedhje.
5. Subjektet politike me të drejtë nominimi për KVV, kanë të drejtë të nominojnë për emërim 10% nga numri i përgjithshëm i anëtarëve për KVV, si anëtarë dhe kryesues rezervë.
6. Pas emërimit, secili anëtar/kryesues i KVV është i obliguar të nënshkruajë marrëveshjen e veçantë mbi shërbimin dhe kodin e mirësjelljes.

Neni 6

Emërimi i KVV

1. Në secilin VV do të shërbejë një (1) ekip i KVV, i cili do të reflektojë përbërjen e KKZ siç përcaktohet në nenin 74.1 të LZP. Për raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave neni 74.2 i LZP nuk është i zbatueshëm.
2. KQZ do të kërkojë nga subjektet politike të konfirmojnë listën e emëruar të anëtarëve të KVV nga raundi i parë dhe t'i propozojnë ndryshimet eventuale. KQZ miraton këto ndryshime jo më vonë se katërmbëdhjetë (14) ditë para ditës së zgjedhjeve.
3. KQZ, u mundëson subjekteve politike të cilat garojnë në raundin e dytë të zgjedhjeve për kryetarë të komunave t'i kenë përfaqësuesit e tyre në KVV..
 - 3.1. Nëse nuk ka nominime të mjaftueshme të pranuar nga ai subjekt politik, atëherë përbërja e KVV mbetet ashtu siç përcaktohet në nenin 5 të kësaj Rregulloreje.
4. KQZ do t'i emërojë 10% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të KVV, të përcaktuar në nenin 79.1 të LZP, si anëtarë rezervë të KVV. Anëtarët rezervë të KVV duhet të zgjidhen nga mesi i anëtarëve të KVV që kanë shërbyer në ekipet e numërimit dhe/ose në ekipet e votimit, apo si anëtarë rezervë për zgjedhjet komunale.
5. KQZ do t'i emërojë ekipet e KVV, jo më vonë se shtatë (7) ditë para ditës së zgjedhjeve, në bazë të rekomandimeve që merren nga Zyrtari Ekzekutiv i Komisionit Komunal të Zgjedhjeve (ZEKKZ).

Neni 7

Përfundimi i anëtarësisë në KVV

1. KQZ mund të revokojë në çdo kohë emërimin e secilit anëtar të KVV, nëse anëtari:
 - 1.1. Nuk merr pjesë në sesionet e trajnimit të organizuara nga KKZ;

- 1.2. ka vijuar trajnimet por nuk punon një ditë para dhe në ditën e zgjedhjeve;
 - 1.3. nuk mund ta kalojë testin pas sesionit të trajnimit;
 - 1.4. vepron në kundërshtim me LZP, kodin e mirësjelljes dhe aktet tjera të KQZ;
 - 1.5. jep dorëheqje për shkaqe personale apo shkarkohet nga subjekti që e ka nominuar;
 - 1.6. për çfarëdo arsye nuk është i gatshëm ose nuk ka mundësi të kryej obligimet e veta.
2. Shkarkimi i anëtarëve të KVV bëhet me vendim të KKZ dhe njoftohet KQZ.

Neni 8

Zëvendësimi i anëtarëve të KVV

1. Për të gjitha rastet e parapara në nenin 5 të kësaj Rregulloreje, anëtari i KVV zëvendësohet nga KKZ me një anëtar rezervë të trajnuar, të të njëjtit subjekt politik dhe të emëruar nga KQZ.
2. Subjekti politik mund të kërkojë përmes KKZ tek KQZ, që të bëjë zëvendësimin e anëtarit të emëruar, jo më vonë se tri ditë para ditës së zgjedhjeve.

Neni 9

Funksionimi i KVV

1. VV lejohet të hapet me një numër minimal prej tre (3) anëtarëve të KVV.
2. KVV duhet të funksionojë me së paku 4 anëtarë të KVV, gjatë tërë procesit zgjedhor.
3. KVV ka këto pozita/funksione:
 - 3.1. Kryesuesi i KVV;
 - 3.2. zyrtari i identifikimit;
 - 3.3. dhënësi i fletëvotimit;
 - 3.4. kontrolluesi i rreshtit;
 - 3.5. mbikëqyrësi i kutisë së votimit;
4. Në rast se mungon ndonjë prej anëtarëve të KVV, kryesuesi informon menaxherin e QV. Menaxheri i QV njofton KKZ dhe kërkon zëvendësimin e tij/saj.

Neni 10

Përgjegjësitë e kryesuesit dhe anëtarëve të KVV para, gjatë dhe pas procesit zgjedhor

1. KVV ushtron veprimtarinë e vet në mënyrë profesionale, të paanshme dhe në shërbim të gjithë votuesve.
2. Kryesuesi i KVV, bashkë me anëtarët e KVV, është përgjegjës për pranimin, mirëmbajtjen dhe kthimin e materialit zgjedhor të ndjeshëm dhe jo të ndjeshëm, të cilin e ka pranuar nga KKZ.
3. Kryesuesi ose anëtarët e KVV janë të obliguar të shënojnë në librin e votimit çdo ngjarje në VV, të shpjeguara sipas doracakut.
4. Kryesuesi i KVV bën pranimin e materialit jo të ndjeshëm një ditë para ditës së zgjedhjeve dhe materialin e ndjeshëm në ditën e zgjedhjeve, sipas planit operacional të KKZ.
5. KVV kryen këto aktivitete para ditës së zgjedhjeve:
 - 5.1. Vijimi dhe përfundimi i suksesshëm i trajnimit;
 - 5.2. pranimi dhe verifikimi i materialit zgjedhor;
 - 5.3. përgatitja dhe rregullimi i vendvotimit.
6. KVV kryen këto aktivitete gjatë ditës së zgjedhjeve:
 - 6.1. Zbatimi i drejtë i procesit të votimit dhe numërimit;
 - 6.2. raportimi lidhur me hapjen dhe mbylljen e VV;
 - 6.3. raportimi lidhur me pjesëmarrjen e votuesve në zgjedhje;
 - 6.4. paketimi dhe transportimi i materialit zgjedhor në depon e KKZ.
7. Pas ditës së zgjedhjeve, anëtarët e KVV mund të kontaktohen nga KQZ për sqarime dhe verifikime shtesë.
8. Nëse mungon kryesuesi, atëherë njëri nga anëtarët e KVV kryen detyrën e kryesuesit të vendvotimit përkohësisht, deri sa KKZ të bëjë zëvendësimin.
9. Anëtarët e KVV nuk mund të dalin apo të largohen nga VV dhe QV, pa lejen e kryesuesit të KVV.
10. Kryesuesi siguron mbarëvajtjen e procesit të votimit.

Neni 11
Të drejtat anëtarëve të KVV

1. Çdo anëtar i KVV, përfshirë edhe anëtarët rezervë, kompensohen për punën e tyre sipas vendimit të KQZ.
2. KQZ do të krijojë kushte që secili anëtar i KVV të pajiset me kopjet e formularëve të cilët ai i nënshkruan, përmes fotokopjimit, fotografimit ose përshtimit.
3. Çdo anëtar i KVV ka të drejtë të komunikojë dhe informojë KKZ për çdo çështje që ai e sheh të arsyeshme.
4. Çdo anëtar i KVV, ka të drejtë të shënojë në librin e votimit vërejtje apo komente, për rrjedhën e procesit në VV, apo të parashtojë ankesë në PZAP.
5. Çdo anëtar duhet të njoftohet me vendimet e KQZ dhe KKZ.

Neni 12
Votimi i anëtarëve të KVV

1. Anëtarët e KVV dhe kryesuesi votojnë të parët kur hapet VV. Nëse VV në të cilin anëtari i KVV është caktuar të votojë është afër, kryesuesi i KVV mund t'ia lejojë anëtarit të KVV të largohet nga VV dhe të votojë.
2. Kryesuesi i KVV duhet të sigurojë që vetëm një anëtar i KVV të mungojë nga VV në të njëjtën kohë, për arsye të votimit.

Neni 13
Dokumenti i identifikimit (distinktivi)

Gjatë ushtrimit të detyrës, anëtarët e KVV janë të detyruar të mbajnë në mënyrë të dukshme dokumentet e identifikimit (distinktivin), të shtypura nga KQZ.

Neni 14
Orari i punës së KVV

1. Orari i punës për KVV, konsiderohet:
 - 1.1. Pjesëmarrja në trajnime, sipas planit operacional të KKZ;
 - 1.2. pranimi i materialit zgjedhor jo të ndjeshëm një ditë para ditës së zgjedhjeve;
 - 1.3. në ditën e zgjedhjeve, deri në përfundimin e procesit të votimit dhe numërimit, ndërsa kryesuesit e KVV deri në dorëzimin e materialit zgjedhor në depon e KKZ.

Neni 15

Vendimmarrja

1. Në rastet kur vendimi është në kuadër të përgjegjësisë të kryesuesit të KVV, vendimi i tij është përfundimtar në VV. Nëse ndonjë anëtar i KVV ose vëzhgues i akredituar nuk pajtohet me vlerësimin apo vendimin e kryesuesit të KVV, ai duhet të shënojë mospajtimin e tij në librin e votimit dhe mund të paraqesë ankesë pranë KQZ.
2. Vendimet e KVV merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të KVV, prezent në KVV.
3. Me pajtimin e anëtarëve të KVV, kryesuesi i KVV, nëse vlerëson se numri i vëzhguesve të akredituar të pranishëm brenda në VV është duke penguar procesin e votimit apo numërimit, ai/ajo duhet t'i urdhërojë vëzhguesit që ta lirojnë VV, që të njëjtën kohë mos të ketë më shumë se një vëzhgues nga një organizatë.
4. Kryesuesi i KVV evidenton në librin e votimit arsyen e zvogëlimit të numrit të vëzhguesve të pranishëm në VV.

Neni 16

Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet që lidhen me punën e KVV, e që nuk janë të rregulluara me këtë Rregullore, përcaktohen me vendim ose me ndonjë akt tjetër të KQZ, në përputhje me LZP.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore, shfuqizohet Rregulla zgjedhore Nr.19/2016 për këshillat e vendvotimeve.
3. Pjesë përbërëse të kësaj rregullore, janë shtojcat:
 - shtojca I- Formulari i nominimeve nga subjektet politike;
 - shtojca II - Formulari i propozimeve nga KKZ në KQZ;
 - shtojca III - Kodi i mirësjelljes për anëtarët e KVV.

Neni 17

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas miratimit nga KQZ.

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi